



Smaltox Mono

Bojë për izolimin e njollave dhe për përdorime të veçanta



Rendimenti i mbulimit: 8 - 10 m²/lt



Koha e tharjes: 1 - 2 orë



Hollimi: deri në 20% me hollues Smaltolux White Spirit



Mundësia për shtresë të dytë: 4 orë



Paketimi: 750 ml, 2,5 lt

Aplikimi: Furçë, rul

KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Astar i bardhë i bazuar në rrëshira akrilike dhe përmbajtje të ulët të VOC, për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm. I përshtatshëm për izolimin efektiv të papastërtive dhe njollave. Zgjidhje ideale për lyerjen e sipërfaqeve shumë të ndotura (nga tymi, smogu, nikotina, myku, lagështia e vjetër, stilolaps furçë, bojërat, shkrike në mure). Ka ngjitje dhe depërtim të shkëlqyer në sipërfaqe të reja suvaje, çimentoje, stukoje, ndërkohë që forcon sipërfaqet e vjetra me suva, suvanë, bojën e prishur etj. Ideal për astar për sipërfaqet e jashtme tashmë të lyera. Ka një mbulim shumë të mirë në kontrast me astarët transparentë DUR, duke kursyer kështu një sasi të bojës përfundimtare. Thahet shpejt dhe rilyhet me bojëra plastike të tretshme në ujë dhe akrilike.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pamja	Mat.
Graviteti specifik	1,41-1,44 kg/lt.
Rendimenti i mbulimit	8-10 m ² /lt për shtresë.
Hollimi	Deri në 20% për vëllim me hollues SMALTOLUX WHITE SPIRIT.
Koha e tharjes	Thahet për 1-2 orë.
Mundësia për shtresë të dytë	Mund ti jepet një shtresë e dytë 4 orë pas aplikimit.
Klasa e POA	a. "Astarë izolues". Lloji D. Vlera e pragut të POA = 450 gr / lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 440 gr/lt. b. "Astarë lidhës". Lloji D. Vlera e pragut të POA = 750gr / lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 550 gr/lt. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e vlimit <250 °C.
Ngjyra	E bardhë. Shmangni lyerjen me SMALTOX mono pa marrë udhëzime të veçanta.



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni plotësisht sipërfaqet nga pluhuri, vajrat, bojërat e mëparshme, pjesët e lirshme, mbetjet e mykut, etj. Smeriloni lehtë sipërfaqen.

APLIKIMI

Përzieni mirë përpara përdorimit. Aplikoni SMALTOX mono në një ose dy shtresa. Mund të rilyhet me bojë emulsioni SMALTOPLAST ekstra, SMALTOPLAST 100% AKRILIKE dhe çdo bojë akrilike ose emulsioni apo me çdo bojë tjetër VECHRO.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini menjëherë ato me ujë të ngrohtë me sapun.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8-30 °C dhe niveli relativ i lagështirës më i ulët se 80 %. Sipërfaqet e reja duhet të thahen për 3-4 javë para se t'u vendoset astari.

RUAJTJA

Pas aplikimit, mbyllni enën fort për ta ruajtur në gjendje të mirë për përdorim në të ardhmen. Mbajeni në vend të freskët. Mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell.

SHËNIME

Referojuni Fletës së të Dhënave të Sigurisë së Materialit (MSDS) për udhëzime të detajuara të sigurisë.

UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve.



Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001, 14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.